



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 799/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani Kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Nusret Maholli, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal nga subjekti politik AAK, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Nusret Maholli, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik AAK me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, me shenjën ZL.Anr.799/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 09.11.2017 në ora 17:10, nga Nusret Maholli, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik AAK me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, me të cilën pretendon se në Lipjan në fshatin Gadime e Ulët, në Qendrat e Votimit QV nr.1307e, 1307e/01R, 1307E/03R, 1307/04R, 1307/06R, 1307E/07D, 1323E/01R, 1323E/02R, 1323E/03R,1302E/02R, 132B/04D, 1302E/05R, 1302E/06D, 1317/01R, 1317E/04D1306E/02R,1306/03D, nuk përputhen rezultatet e votave në mes të Formularit të Rezultateve Përfundimtare dhe Formularit të Rezultatit të Kandidatëve, duke theksuar se ka pasur pa rregullsi lidhur me procesin e numërimit të votave.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i apelit në apelin e parashtruar nuk e ka potencuar se sa vota i mungojnë në Lipjan në fshatin Gadime e Ulët, në Qendrat e Votimit QV nr.1307e, 1307e/01R, 1307E/03R, 1307/04R, 1307/06R, 1307E/07D, 1323E/01R, 1323E/02R, 1323E/03R,1302E/02R, 132B/04D, 1302E/05R, 1302E/06D, 1317/01R, 1317E/04D1306E/02R,1306/03D dhe në mbështetje të pretendimeve në apel nuk ka ofruar asnjë dëshmi bindëse për të vërtetuar pretendimet në apel, ashtu si kërkohet në nenin 117 par. 3 të LZP-së, ku është përcaktuar: “*se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”. Paneli gjatë vendosjes për një apel i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në apel dhe kur vlerëson se pretendimet në apel nuk janë të provuara me prova e refuzon apelin si të pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë duke u bazuar në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)

Anr.799/2017 më datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*